



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I HISTORI-GJEOGRAFISË**

Nr. _____ prot

Elbasan, më 16.04.2025

Lënda: Temat e provimit me shkrim për kandidatët fitues të fazës së parë në programin e studimit “doktoratë në albanologji”, viti akademik 2024-2025

FUSHA STUDIME HISTORIKE

Histori botërore antike

1. Veçoritë e qytetërimeve të Lindjes së Lashtë, në fushat ekonomike, shoqërore, politike e kulturore. Kultura e lashtë egjyptiane.
2. Klasifikimi i poliseve greke sipas nivelit të zhvillimit ekonomik, shoqëror e politik në shekullin IV-V p.e.r.
3. Periudha e Perikliut, demokracia Athinase.
4. Helenizmi, tiparet e tij.
5. Politika shoqërore e Augustit.
6. Shkaqet e luftës së plebejve kundër patricëve në shek. V-VI p.e.r.
7. Shkaqet e drejtimeve në të cilat u shfaq kriza e Perandorisë Romake.

Histori mesjete

1. Kristianizmi, mosmarrveshjet doktrinale.
2. Monarkizmi i krishterë.
3. Ekspansioni ushtarak i Karlit të Madh.
4. Shpallja e perandorisë Karoline.
5. Kryqëzata e IV dhe krijimi i Perandorisë Latine.
6. Franca në fillim të shek. XIV.

7. Monarikia dhe parlamenti në Angli.

8. Sistemi i shteteve rajonale italiane.

Histori e shqiptarëve (Histori e Shqipërisë 1)

1. Gjurmët më të hershme të jetës njerëzore në territorin e vendit tonë. Stacionet paleolitike, popujt më të vjetër të Ballkanit. Etnosi Ilir.
2. Origjina e Ilirëve, trualli i tyre historik, fiset Ilire, kultura. Kolonitë helene në bregdetin Ilir.
3. Krijimi i qyteteve dhe shteteve Ilire. Mbretëria Ilire. Fazat e zhvillimit të saj.
4. Shteti i Epirit. Kuptimi gjeografik, etnik e politik i nocionit Epir. Lidhja Mollose. Aleanca Epiriote. Epiri nën sundimin e Pirros. Lidhja Epiriote.
5. Mbretëria Dardane. Territori, popullsia, konflikti me Maqedoninë, qëndrimi ndaj Romës. Qëndresa Ilire ndaj pushtimit romak. Federata Dalmate.
6. Lindja dhe pranimi i kriptokristianizmit në trevat tona. Dyndjet barbare. Formimi i popullit shqiptar dhe gjeneza e tij.
7. Formacionet politike shtetërore shqiptare. Principata e Arbërit si shtet i parë feudal shqiptar mesjetar. Principatat feudale shqiptare të shek. XIV.
8. Kultura mesjetare shqiptare. Arsimi, letërsia, arti.
9. Vërshimi Osman në Ballkan dhe në Shqipëri. Regjistrimet kadastrale, pasojat. Qëndresa antiosmane në vitet '20-'30-të të shek XV.
10. Kuvendi i Lezhës, kryengritjet çlirimtare shqiptare nën udhëheqjen e Skënderbeut.

Histori Shqipërie 2

1. Programi i Rilindjes Kombëtare Shqiptare.
2. Shkaqet e Krizës Lindore të viteve '70 të shek XIX, reagimi shqiptar.
3. Konkretizimi i politikës antishqiptare në Traktatin e Shën Stefanit e Kongresin e Berlinit, reagimi shqiptar.
4. Interpretimi i domosdoshmërisë së ndryshimit të strategjisë dhe platformës së rilindasve pas shtypjes së Lidhjes shqiptare të Prizrenit.
5. Analizë e situatës arsimore dhe kulturore në Shqipëri në fillim të shek XX-të dhe masat e marra për zgjidhjen e problematikave që paraqiteshin.
6. Argumentim i ndryshimit të kërkesave politike të shqiptarëve në periudhën tetor-nëntor 1912.
7. Kuvendi i Vlorës dhe vendimit e tij.

Histori Shqipërie 3

1. Konferenca e Ambasadorëve të Londrës dhe çështja shqiptare (vendimet mbi Shqipërinë, statusin e shtetit shqiptar dhe çështjen e kufijve (veriorë e jugorë).
2. Ardhja e Princ Vidit në Shqipëri. Veprimtaria e Qeverisë së Vidit. Kryengritja e Shqipërisë së Mesme (1914-1915), pasojat.
3. Lufta e Parë Botërore dhe Shqipëria. (zonat e pushtimit dhe politikat e ndjekura).

4. Kongresi i Durrësit i 25 dhjetorit 1918, vendimet. Formimi i qeverisë së përkohshme. Çështja shqiptare në Konferencën e Paqes në Paris. Veprimtaria e delegacionit shqiptar në Konferencën e Paqes.
5. Jeta politike shqiptare e viteve 1920-1924. Parlamentarizimi, pluralizmi zhvillimi i ideve liberal-demokrate. (zgjedhjet parlamentare të Prillit 1921, zgjedhjet për Asamble Kushtetuese të Dhjetorit 1923).
6. Kriza qeveritare e Dhjetorit 1921, kryengritja e Marsit 1922, pasojat mbi jetën politike e shtetin shqiptar.
7. Përpyjekjet e Ahmet Zogut në drejtim të krijimit të shtetit ligjor në dy etapat qeverisëse Republikë Parlamentare shqiptare dhe Monarki Parlamentare shqiptare. Reformat e ndërmara në fushën administrative, jetën shoqërore, arsim, ekonomi dhe fushën financiare. Njohja ndërkombëtare e Shqipërisë, paktet e nënshkruara me Italinë, marrëdhëniet me fqinjët.
8. Arsimi në Shqipëri në vitet 1912-1939.
9. Lufta e Dytë Botërore dhe Shqipëria (qëndresa antifashiste, krijimi i PKSH, Ballit Kombëtar dhe Legalitetit, programet, bashkëpunimet dhe shpëtimet e madhe -Mbledhja e Mukjes.
10. Fundi i Luftës së Dytë Botërore, çlirimi i vendit. Organizimi i zgjedhjeve për legjitimimin e pushtetit, hapat e para të liberalizimit të politikës në vend pas çlirimit. Vendosja e regjimit komunist dhe rruga drejt konsolidimit të tij.
11. Orientimi i Shqipërisë drejt Bllokut Lindor. Politikat e ndjekura dhe anëtarësimi në organizmat e bllokut.
12. Arsimi në Shqipëri në vitet 1945-1990.
13. Politika e jashtme e shtetit shqiptar në vitet 1945-1990. (marrëdhëniet me Jugosllavinë, Bashkimin Sovjetik dhe Kinën).
14. Ndryshimet politike në vend në vitin 1990 si rrjedhojë e ndryshimeve që ndodhën në vendet e Evropës Juglindore, shembjes së Murit të Berlinit.
15. Tranzicioni postkomunist në Shqipëri dhe sfidat drejt integritetit evropian.

Histori e sotme e Botës

1. Treguesit themelorë që karakterizuan revolucionin e dytë industrial. Rrjedhojat kryesore të zhvillimit të tij.
2. Kuptimi mbi sistemin e qeverisjes së demokracisë liberale (fillimi i shek XX).
3. Përpyjekjet për demokraci që u evidentuan në vendet me traditë autoritariste të sistemit qeverisës.
4. Kriza e Marokut dhe Gadishullin Ballkanik në vitet 1900-1914. Pasojat që sollën.
5. Kriza ndërkombëtare e verës së vitit 1914. Fillimi i Luftës së Parë Botërore dhe përgjegjësit realë të shpërthimit të saj.
6. Origjina e lindjes dhe triumfit të fashizmit në Itali dhe në nazizmit në Gjermani. Paralele, specifika.

7. Tiparet e përbashkëta dhe të veçanta që rezultojnë si rrjedhojë e krahasimit të dy luftrave botërore.
8. Kuptimi mbi luftën e ftohtë dhe karakteristikat e zhvillimit të saj në vitet '50-'80-të të shek XX.
9. Argumentoni procesin historik të krijimit të OKB-së.